



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 167**

**22 tetor**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 856, datë 30.9.2013	Për shfuqizimin e vendimit nr. 724, datë 28.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Katund i Vjetër dhe Reja e Velës””.....	7431
Vendim i KM nr. 858, datë 30.9.2013	Për shfuqizimin e vendimit nr. 689, datë 16.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “BLAC””.....	7431
Vendim i KM nr. 859, datë 30.9.2013	Për shfuqizimin e vendimit nr. 679, datë 16.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “GAFER””.....	7432
Vendim i KM nr. 939, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.....	7432
Vendim i KM nr. 940, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë.....	7434
Vendim i KM nr. 941, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Jashtme.....	7435
Vendim i KM nr. 942, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.....	7436
Vendim i KM nr. 943, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.....	7437

Vendim i KM nr. 944, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.....	7438
Vendim i KM nr. 945, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Mjedisit.....	7439
Vendim i KM nr. 946, datë 9.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Integritimit Evropian .....	7440
Vendim i KM nr. 947, datë 30.9.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes.....	7441
Vendim i KM nr. 950, datë 9.10.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 62, datë 1.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e funksionimit të Komisionit të Çmimit të Barnave”.....	7442
Vendim i KM nr. 954, datë 16.10.2013	Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.....	7442
Urdhër i MM nr. 893, datë 4.10. 2013	Për miratimin e modelit të regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vavra të përdorura.....	7444
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Erjon Korobacja.....	7451

**VENDIM**  
**Nr. 856, datë 30.9.2013**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 724, DATË 28.8.2013 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE  
KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË  
HIDROCENTRALIT “KATUND I VJETËR DHE REJA E VELËS””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shfuqizimin e vendimit nr. 724, datë 28.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Katund i Vjetër dhe Reja e Velës””.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 858, datë 30.9.2013**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 689, DATË 16.8.2013 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE  
KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË  
HIDROCENTRALIT “BLAC””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shfuqizimin e vendimit nr. 689, datë 16.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Blac””.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



**VENDIM**  
**Nr. 859, datë 30.9.2013**

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 679, DATË 16.8.2013 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE  
KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË  
HIDROCENTRALIT “GAFER””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Shfuqizimin e vendimit nr. 679, datë 16.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Gafer””.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 939, datë 9.10.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË  
BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Miratimin e misionit, të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe të kompetencave në përbushje të tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ka për mision zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, administrimit të ujërave, peshkimit dhe akuakulturës.

III. Për të përbushur misionin e sipërpërmendur, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ushtron këto kompetenca:

1. Harton dhe zbaton politikat shtetërore për çështjet e bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes së konsumatorit, administrimit të ujërave, peshkimit dhe akuakulturës.

2. Përgatit strategjitë, planet kombëtare të veprimit, programet dhe aktet ligjore e nënligjore për fushat e veprimtarisë që mbulon, si dhe siguron zbatimin e tyre.

3. Ndjek me përparësi proceset integruese dhe bashkërendon punën për bashkëpunimin ndërkombëtar për fushat që mbulon, në përputhje me politikën e jashtme dhe të zhvillimit të vendit.

4. Kujdeset për përafrimin e legjislacionit në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, ushqimit e mbrojtjes së konsumatorit, administrimit të ujërave, peshkimit dhe akuakulturës me normat dhe kërkesat e Bashkimit Evropian dhe strukturat përkatëse, si dhe vlerëson nevojat e planifikon fondet e nevojshme për përmbushjen e tyre.

5. Harton dhe zbaton politikat orientuese, mbështetëse dhe nxitëse për prodhimin bujqësor e blegtoral, si dhe kujdeset për zhvillimin e koordinuar të bujqësisë.

6. Ndjek me përparësi përgatitjen e strukturave të saj për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të Komisionit Evropian për Zhvillimin Rural në përputhje me aktet rregullatore të Bashkimit Evropian.

7. Përcakton politikat dhe zbaton mbështetjen financiare të qeverisë për fermerët dhe agrobizneset bazuar në politikat e programit të qeverisë për mbështetjen e tyre.

8. Kujdeset për konsolidimin dhe miradministrimin e tokës bujqësore, si dhe mbrojtjen e tokës nga proceset natyrore dhe faktorët e tjerë që mund ta dëmtojnë atë.

9. Kujdeset për ngritjen dhe menaxhimin e sistemeve të ujitjes e të kullimit, si dhe merr masa të përshtatshme për mbrojtjen e tokave nga përmytjet.

10. Harton dhe zbaton politikat për sigurinë ushqimore, cilësinë e produkteve ushqimore, duke përfshirë gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë.

11. Kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit lidhur me produktet ushqimore të vendosura në treg.

12. Harton dhe zbaton politikat për shëndetin e kafshëve e të bimëve, si dhe për garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin prej tyre.

13. Siguron, administron dhe shpërndan informacionin bujqësor, duke vendosur një marrëdhënie të qëndrueshme dhe bashkëpunuese me fermerët. Kujdeset për transferimin e teknologjive bujqësore dhe planifikon zbatimin e teknologjive të reja.

14. Bashkërendon punën me strukturën e shërbimit këshillimor për dhënien e informacionit dhe për mundësimin e trajnimeve për fermerët e operatorët e biznesit ushqimor dhe kujdeset për fuqizimin e këtij shërbimi në përputhje me rekomandimet e BE-së.

15. Harton dhe zbaton politikat shtetërore për peshkimin dhe akuakulturën në Shqipëri, menaxhimin e burimeve peshkore dhe përafrimin e akteve ligjore e nënligjore me kërkesat dhe legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

16. Harton dhe zbaton politikat për marketingun agrar dhe agropërpunues. Përgatit strategji dhe projekte, duke bashkëpunuar edhe me organizma ndërkombëtarë për analizimin e zhvillimin e shkëmbimeve tregtare dhe sidomos për rritjen e eksportit të produkteve shqiptare.

IV. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



**VENDIM**  
**Nr. 940, datë 9.10.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË  
SË SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Shëndetësisë ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës: “Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.”.

III. Ministria e Shëndetësisë ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Zhvillimin e politikave e të strategjive shtetërore në fushën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

2. Zhvillimin dhe monitorimin e politikave të legjislacionit, të programeve e të veprimtarive që lidhen me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe me treguesit shëndetësorë të popullatës.

3. Krijimin e një kuadri ligjor të plotë për të garantuar të drejtat themelore shëndetësore të të gjithë shtetasve, si dhe mbrojtjen e konsumatorit joushqimor.

4. Krijimin e një kuadri të plotë, ligjor e bashkëkohor, për konsolidimin e financimit të kujdesit shëndetësor.

5. Zhvillimin e strategjive e të politikave që synojnë përmirësimin gradual të performancës të të gjithë ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet sistemit të akreditimit.

6. Zhvillimin e politikave e të programeve kombëtare që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit, si dhe parandalimin, diagnostikimin e trajtimit e sëmundjeve në popullatë.

7. Hartimin dhe rishikimin e standardeve të të gjitha shërbimeve shëndetësore, të të gjithë ofruesve të kujdesit shëndetësor, si dhe të mbrojtjes së konsumatorit joushqimor.

8. Hartimin dhe përditësimin e të gjitha protokolleve të mjekimit sipas praktikave bashkëkohore.

9. Inspektimin, monitorimin dhe vlerësimin e bazuar në evidencë të të gjitha shërbimeve shëndetësore dhe të të gjithë ofruesve të kujdesit shëndetësor për garantimin e një shërbimi cilësor të arritshëm për çdo individ në nevojë.

10. Racionalizimin dhe rajonalizimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për të garantuar akses të barabartë dhe shpërndarje të efektshme të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

11. Garantimin e burimeve njerëzore të afta për t’iu përgjigjur nevojave bashkëkohore të sistemit shëndetësor.

12. Monitorimin dhe vlerësimin periodik të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve shëndetësore.

13. Monitorimin dhe bashkëpunimin me “urdhrrat profesionalë” dhe ofruesit jopublikë të kujdesit shëndetësor sipas legjislacionit dhe praktikës më të mirë përkatëse.

14. Hartimin dhe ndërtimin e sistemit të informacionit shëndetësor në të gjitha hallkat, nivelet dhe ofruesit (publikë dhe jopublikë) e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

15. Garantimin e transparencës, të komunikimit e të informimit publik mbi të gjitha çështjet e lidhura me shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjen e konsumatorit.

16. Bashkërendimin e punës dhe harmonizimin e programeve e të veprimtarive të të gjithë aktorëve të interesuar e të përfshirë në garantimin e shëndetit të popullatës dhe mbrojtjes së konsumatorit joushqimor.

17. Bashkërendimin e punës dhe monitorimin e politikave ndërsektoriale shëndetësore që hartohen dhe zbatohen në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore.

IV. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

#### **VENDIM**

**Nr. 941, datë 9.10.2013**

### **PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

2. Ministria e Punëve të Jashtme e ushtron veprimtarinë e saj në fushën e përgjegjësisë shtetërore, të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e fushës së përgjegjësisë, ushtron kompetencat e parashikuara në nenin 6 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

4. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**



**VENDIM**  
**Nr. 942, datë 9.10.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË  
PUNËVE TË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Punëve të Brendshme është organi përgjegjës për zbatimin e politikës së punëve të brendshme në Republikën e Shqipërisë, është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e punëve të brendshme.

III. Ministria e Punëve të Brendshme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Mbrojtjen e jetës së njerëzve, të sigurisë e të pronës së tyre personale.
2. Parandalimin, zbulimin dhe hetimin, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural penal, të veprave penale e të autorëve të kryerjes së tyre.
3. Mbrojtjen e rendit e të sigurisë publike.
4. Mbikëqyrjen dhe drejtimin e trafikut rrugor në rrugë për përdorim publik, në përputhje me legjislacionin rrugor.
5. Mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.
6. Mbrojtjen e individëve, të mjediseve e të objekteve të caktuara nga rreziqe të mundshme.
7. Hyrjen, qëndrimin, punësimin, trajtimin dhe daljen e të huajve në/nga Republika e Shqipërisë.
8. Marrjen e masave për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë.
9. Garantimin e komunitetit për një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, kur janë plagosur apo kur punonjësit kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës.
10. Monitorimin dhe bashkëpunimin me institucionet e ngarkuara për zbatimin e masave në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
11. Ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të rezidencave të përcaktuara.
12. Mbrojtjen e të drejtave civile të shtetësisë dhe azilit.
13. Ndjekjen e procedurave për realizimin e të drejtave për arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor e shoqëror, strehimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë.
14. Organizimin e funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.
15. Pajisjen e të gjithë shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një dokument identifikues unik, me pasaportë, si dhe përcaktimin e kuptimit, të mënyrës së formimit e të sferës së përdorimit të numrit personal.



16. Përcaktimin e mënyrës së krijimit dhe të administrimit të sistemit të adresave.
  17. Parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
  18. Mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të pronës nga rreziku i zjarrit dhe i fatkeqësive natyrore e fatkeqësive të tjera në rastet e emergjencave civile.
  19. Ministria e Punëve të Brendshme, nëpërmjet institucionit të prefektit bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe funksionet e deleguara të tyre me njësitë e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qarqe.
  20. Vendosjen e bazave juridike dhe administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit.
  21. Krijimin e kushteve për trajtimin e punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shfrytëzimin e mjediseve të Shtëpisë së Pushimit për nevoja të kësaj ministrie.
  22. Sigurimin e mbështetjes së gjendjes teknike të automjeteve të Policisë së Shtetit dhe të aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
  23. Kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve.
  24. Kryerjen e procesit të inventarizimit e të transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, drejtimin e procesit të inventarizimit të pasurive të paluajtshme publike, që administrohen nga institucionet e pushtetit qendror, propozimet për shpronësimet për interes publik nga njësitë e qeverisjes vendore dhe përgatitjen e akteve që dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave.
  25. Administrimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe të dokumentacionit të arkivave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
  26. Përgjegjësi të tjera në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të përcaktuara në bazë të legjislacionit në fuqi.
- IV. Ministria e Punëve të Brendshme përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit brenda fushës së përgjegjësisë, sipas pikës III të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 943, datë 9.10.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETETËRORE TË MINISTRIT TË SHETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Miratimin e misionit, të fushave të përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, si dhe të kompetencave për realizimin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.



II. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ushtron me përgjegjësi të plotë veprimtarinë e tij në procese, që kanë të bëjnë veçanërisht me hartimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e teknologjisë së informacionit e të komunikimit elektronik, infrastrukturën e informacionit gjeohapësinor, shërbimit postar, mediat audiovizive dhe në fushën e administratës publike.

III. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Zhvillimin dhe bashkërendimin e politikave të legjislacionit, të programeve e të veprimtarive, sipas kompetencave të parashikuara nga ligjet specifike, në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, mediave audiovizive, si dhe të infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

2. Bashkërendimin e punës për hartimin e strategjisë së integruar të inovacionit dhe të teknologjisë së informacionit.

3. Drejtimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e administratës publike, si dhe është përgjegjës për hartimin dhe bashkërendimin e politikave për reformimin dhe modernizimin e administratës publike.

IV. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ushtron funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin, si dhe kryen detyra të tjera të deleguara nga Kryeministri.

V. Ngarkohet ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 944, datë 9.10.2013

### PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit harton dhe zbaton politika që synojnë modernizimin e zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban, strehimit, legalizimit e integritit të ndërtimeve informale dhe turizmit.

III. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Fushën e planifikimit e të zhvillimit urban, administrimit të tokës dhe zhvillimit të qëndrueshëm e kontrollit të territorit.

2. Fushën e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

3. Fushën e strehimit.
  4. Fushën e legalizimit e të integritit të zonave dhe ndërtimeve informale.
  5. Fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial.
- IV. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, të strategjive e të politikave në fushat e përgjegjësisë shtetërore që mbulon.
- V. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 945, datë 9.10.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHETËRORE TË MINISTRISË SË**  
**MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit (MM), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Mjedisit harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, nxitjen dhe promovimin e burimeve të rinovueshme, mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, si dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore.

III. Ministria e Mjedisit e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës:

1. Sektorin e mjedisit, përfshirë politikën, standardet dhe monitorimin e mbetjeve urbane, cilësinë e ajrit, zhurmat, ndotjen industriale, kimikatet, ndryshimet klimatike dhe monitorimin e treguesve të mjedisit, vlerësimin e ndikimit në mjedis.

2. Natyrën dhe biodiversitetin, përfshirë florën dhe faunën, mbrojtjen e tokës nga erozioni e degradimi, mbrojtjen e peizazhit natyror, mbrojtjen e faunës së egër e të specieve të rrezikuara dhe zonat e mbrojtura.

3. Sektorin e burimeve ujore, përfshirë ujërat e brendshme, ujërat nëntokësore dhe ujërat detare.

4. Sektorin e pyjeve dhe kullotave.

IV. Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për hartimin e strategjive ndërsektoriale e sektoriale, si dhe të planeve kombëtare e rajonale të veprimit për fushat e veprimtarisë shtetërore, sipas përcaktimit të pikës III të këtij vendimi. Kjo ministri mund ta ushtrojë këtë detyrë vetëm ose së bashku me ministri të tjera, sipas delegimit që i bën Këshilli i Ministrave, bazuar në legjislacionin përkatës.

V. Ministria e Mjedisit luan rolin e sekretariatit teknik për Këshillin Kombëtar të Ujit.



VI. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

### VENDIM

Nr. 946, datë 9.10.2013

## PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË INTEGRIMIT EVROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Integrimit Evropian (MIE), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Integrimit Evropian ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, hartimit të politikave të integrimit, bashkërendimit të ndihmave financiare nga Bashkimi Evropian dhe informimit të publikut për këtë proces.

III. Ministria e Integrimit Evropian ushtron këto veprimtari:

1. Bashkërendon punën dhe monitoron përgatitjet e institucioneve shqiptare dhe angazhimet e ndërmarra prej tyre, në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit.

2. Bashkërendon, monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, të dala nga takimet e përbashkëta me Bashkimin Evropian, në nivele të ndryshme.

3. Përgatit mekanizmat metodologjikë në funksion të lehtësimit të zbatimit të reformave sektoriale, që rrjedhin nga negociimi dhe zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

4. Bashkërendon punën ndërmjet ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore për hartimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, me qëllim realizimin e objektivave të përcaktuara në kuadër të procesit të integrimit evropian.

5. Bashkërendon, monitoron dhe analizon ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, duke mbajtur lidhje të rregullta institucionale me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore.

6. Harton, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, planin kombëtar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, si dhe kontrollon zbatimin e këtij plani dhe të programeve të tjera të lidhura me partneritetin evropian.

7. Vlerëson përputhshmërinë e projektakteve normative të propozuara nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore me të drejtën e Bashkimit Evropian, të cilat duhet të pasqyrojnë në relacionin shoqëruar shkallën e përafrimit dhe referencat për legjislacionin përkatës dhe jurisprudencën e Bashkimit Evropian.

8. Bashkërendon punën dhe ndihmon ministrinë e linjës e institucionet e tjera qendrore për hartimin e legjislacionit të nevojshëm, me qëllim përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

9. Konfirmon përkthimin e dokumentacionit bazë, të nevojshëm për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian.

10. Bashkërendon, programon dhe monitoron ndihmën e Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë (fondet IPA, instrumenti TAIEEX, si dhe programe të tjera ndihme, që mund t'i ofrohen Republikës së Shqipërisë), sipas përparësive të vendit tonë, në kuadër të procesit të integritimit evropian.

11. Bashkërendon dhe ndjek nënshkrimin e marrëveshjeve të ndihmave financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të programeve të përcaktuara në pikën 10.

12. Udhëheq dhe bashkërendon punën e ministrive të linjës e të institucioneve të tjera qendrore në përgatitjen e projekteve parësore dhe, në kuadër të programeve të përcaktuara në pikën 10 të kësaj ndarjeje, ia paraqet për mbështetje financiare Bashkimit Evropian.

13. Merr pjesë në veprimtarinë e grupeve të punës, të ngritura nga institucione të tjera shtetërore, për hartimin e programeve të ndryshme për integrimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

14. Shkëmben të dhëna, organizon takime periodike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar dhe trajnon stafin e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera në funksion të procesit të integritimit evropian.

IV. Ministria e Integritimit Evropian në marrëdhëniet me të tretët:

a) bashkërendon punën për hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut për çështjet e integritimit evropian;

b) propozon ngritjen e grupeve teknike të punës, në funksion të përmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian;

c) kërkon nga ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore përgatitjen dhe paraqitjen në afatet e caktuara të dokumenteve, në funksion të procesit të integritimit evropian;

ç) njofton organet përkatëse të Bashkimit Evropian për përafrimin e akteve normative vendase me të drejtën e Bashkimit Evropian;

d) përgatit dhe paraqet raporte për procesin e integritimit evropian në Komitetin Ndërmintor të Integritimit dhe Komitetin e Koordinimit Ndërinstitucional për integrimin evropian;

dh) informon komisionet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të interesuara për procesin e integritimit evropian, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese.

V. Mënyra e komunikimit të Ministrisë së Integritimit Evropian me misionin shqiptar pranë Bashkimit Evropian rregullohet nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët të ministrit të Punëve të Jashtme dhe të ministrit të Integritimit Evropian.

VI. Ngarkohet Ministria e Integritimit Evropian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 947, datë 30.9.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Ministria e Mbrojtjes ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Strategjinë Ushtarake dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ajo përbëhet nga administrata e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**

VENDIM

**Nr. 950, datë 9.10.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 62, DATË 1.2.2012 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ÇMIMIT TË  
BARNAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 51 të ligjit nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 62, datë 1.2.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 6 fjalët “... datës 5 tetor ...” zëvendësohen me “... datës 20 tetor ...”.
2. Në pikën 7 fjalët “... datës 5 nëntor ...” zëvendësohen me “... datës 20 nëntor ...”.
3. Në pikën 8 fjalët “... datës 15 dhjetor ...” zëvendësohen me “... datës 25 dhjetor ...”.
4. Në pikën 19 fjalët “... datës 25 dhjetor ...” zëvendësohen me “... datës 30 dhjetor ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Edi Rama**

VENDIM

**Nr. 954, datë 16.10.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË  
TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e misionit dhe të fushave të përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e transportit dhe infrastrukturës në Shqipëri nëpërmjet hartimit, përmirësimit të strategjive, planeve të veprimit dhe të legjislacionit në këta sektorë, si dhe zbatimin e tyre.

III. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Përgatitjen dhe zbatimin e objektivave e të politikave të qeverisë për zhvillimin e transportit e të ujësjellës-kanalizimeve në të gjitha elementet përbërëse të tyre, si dhe për mbetjet urbane në aspektin e zbatimit të projekteve të tyre.

2. Hartimin e politikave të zhvillimit të transportit dhe infrastrukturës, ku bëjnë pjesë infrastruktura e transportit, përfshirë edhe atë me tubacione për ujësjellës-kanalizimet dhe bashkërendimi i politikave të infrastrukturës së mbetjeve urbane në komponentin zbatues të tyre dhe ndjekjen e zbatimit e këtyre politikave në hallkat e varësisë.

3. Përcaktimin e tendencave e të prirjeve nga analizat statistikore në transport e infrastrukturë, hartimin e treguesve makroekonomikë, afatshkurtër e afatgjatë, të zhvillimit të përgjithshëm, si dhe hartimin, zbrërthimin dhe ndjekjen e treguesve të projektprogrameve ekonomike-financiare të investimeve.

4. Drejtimin, menaxhimin, supervizimin dhe vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, tubacioneve, porteve, aeroporteve, ujësjellës-kanalizimeve, venddepozitimeve të mbetjeve dhe digave të mëdha të hidrocentraleve. Përcaktimin dhe vendosjen e standardeve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit dhe organizimin e drejtimit të kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit.

5. Monitorimin e realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës në transport, ujësjellës-kanalizime, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar dhe teknik.

6. Zhvillimin e hapësirës së nismës së lirë private në aktivitetet e shërbimit të llojeve të transportit, si dhe krijimin e kushteve për një konkurrencë të drejtë ndërmjet llojeve të transportit e zhvillimin e konkurrencës në sistemin e licencimit.

7. Shqyrtimin dhe propozimin në programimin e burimeve të financimit të brendshëm e të jashtëm (me donatorë të huaj dhe përmes partneritetit publik privat), për të mbuluar nevojën e zhvillimit të ndërtimit të infrastrukturës të transportit dhe ujësjellës-kanalizimeve e të mbetjeve urbane.

8. Bashkërendimin e punës me ministritë e tjera dhe institucionet ndërkombëtare financiare e shtete partnere të ndryshme, për sigurimin e burimeve të domosdoshme të financimit, në mënyrë që të krijojë mundësi zhvillimi dhe harmonizimi:

a) për ujësjellës-kanalizimet dhe trajtimin e mbetjeve me qëllim mbulimin sa më të gjerë të popullsisë me ujë, ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e cilësisë së jetës në vend;

b) për të gjitha llojet e transportit për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë së vendit nëpërmjet përmirësimit të lëvizjes së mallrave dhe njerëzve.

9. Drejtimin, përmirësimin, zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të informacionit në transport dhe infrastrukturë për sigurimin e burimit të të dhënave të gjithanshme e të vazhdueshme, për krijimin e kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operuesve vendas e të huaj, si dhe të përshtatshme për t'u inkuadruar në sistemet evropiane të informacionit.

10. Negocimin, përgatitjen dhe nënshkrimin (me autorizim të organeve kompetente) e marrëveshjeve të transportit dhe infrastrukturës, sipas llojeve, me shtete të ndryshme. Zgjerimin e



bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtar përmes aderimit në organizatat ndërkombëtare dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

IV. Ministria kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësishë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë apo u ngarkohen me ligj agjencive autonome.

V. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

### **URDHËR**

**Nr. 893, datë 4.10.2013**

### **PËR MIRATIMIN E MODELIT TË REGJISTRAVE TË SUBJEKTEVE QË GJENEROJNË, GRUMBULLOJNË DHE RICIKLOJNË VAJRA TË PËRDORURA**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 27 dhe 66 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe të vendimit nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” të Këshillit të Ministrave,

### **URDHËROJ:**

1. Miratimin e regjistrave të subjekteve që gjenerojnë, grumbullojnë dhe riciklojnë vajra të përdorura, sipas modeleve bashkëlidhur këtij urdhri.

1.1 Librin e regjistrimit për prodhuesit dhe importuesit e vajrave lubrifikante.

1.2 Librin e regjistrimit për gjeneruesit e mbetjeve vajore.

1.3 Librin e regjistrimit për menaxhuesit e licencuar të grumbullimit dhe riciklimit të vajrave lubrifikante të përdorura.

1.4 Etiketën “Ruajtje në ambalazh të veçantë” për grumbulluesit e vajrave lubrifikante të përdorura.

1.5 Dokument për marrjen në dorëzim të mbetjeve vajore.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit për Mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve, agjencitë rajonale të mjedisit në qarqe dhe lidhur me procedurën e botimit në Fletoren Zyrtare, si dhe procedurën përkatëse të prokurimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse.

3. Urdhri nr. 204, datë 13.3.2013 “Për miratimin e modelit të regjistrave, dokumenteve dhe formateve të regjistrimit të subjekteve” i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MJEDISIT**  
**Lefter Koka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT  
**AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT**

---

LIBRI I REGJISTRIT PËR PRODHUESIT DHE IMPORTUESIT  
E VAJRAVE LUBRIFIKANTE



Libri nr. \_\_\_\_\_

Libri i regjistrimit të të dhënave të vajrave lubrifikante apo industriale që importohen ose janë prodhim vendas, të cilat duhet të regjistrohen në regjistrin e miratuar nga Ministria e Mjedisit në zbatim të ligjit nr. 10 463, datë. 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” dhe VKM nr. 765, datë 7.11.2012, si detyrim ligjor për subjektet që prodhojnë, importojnë apo shesin produktin në tregun shqiptar, duke qenë se prodhuesit e vajrave lubrifikante dhe industriale janë përgjegjës për financimin e grumbullimit, transportimit dhe trajtimit, për sasinë e minimumit të 80% të vajrave të përdorura, të sasisë së trajtuar në vit nga ana e tij, në respektim të parimit “NDOTËSI PAGUAN”.

Data: \_\_\_\_\_  
Agjencia Rajonale e Mjedisit  
Qarku: \_\_\_\_\_  
Kryetari: \_\_\_\_\_

Emri i subjektit : \_\_\_\_\_  
Prodhues i vajrave: \_\_\_\_\_  
Adresa: \_\_\_\_\_  
NIPT: \_\_\_\_\_  
Lloji i aktiviteti: \_\_\_\_\_  
Leje mjedisore nr: \_\_\_\_\_  
Libri i regjistrimit nr: \_\_\_\_\_  
Administratori: \_\_\_\_\_

TË DHËNAT E PRODHUESVE TË VAJRAVE NGA IMPORTI OSE PRODHIMI VENDAS

Nr.	Origjina e vajrave lubrifikante dhe industriale		Sasia		Data		Blerësi			Nr. i faturës tatimore
	Importi	Prodhim vendas	Kg	Litra	Data e blerjes	Data e shitjes	Subjekti	NIPT-i	Adresa	
1.										
2.										
3.										
4.										
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										



### HYRJET-DALJET E TREGTUESEVE DHE PIKAVE TË SHITJES

Sasia e blerjes		Të dhënat e tregtuesit			Data e blerjes	Nr. i faturës tatimore të blerjes	Sasia e shitjes	Të dhënat e blerësit			Data e shitjes	Nr. i faturës tatimore të shitjes
Nr.	Kg ose litra	Subjekti	NIPT-i	Adresa			Kg ose litra	Subjekti	NIPT-i	Adresa		
1.												
2.												
3.												
4.												
5.												
6.												
7.												
8.												
9.												

**DOKUMENT PER MARRJE NE DOREZIM TE VAJRAVE TE PERDORUR**

(BAZUAR NE VKM NR.765, DATË \_07/11/2012 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR DHE TRAJTIMIN E VAJRAVE TË PËRDORURA)

MIRATUAR NGA MINISTERIA E MJEDISIT

**FATURE Nr.** \_\_\_\_\_

**TE DHENAT E SUBJEKTIT  
QE PRODHON V.P.**

EMRI \_\_\_\_\_

NIPT

ADRESA \_\_\_\_\_

QYTETI \_\_\_\_\_

TELEFON \_\_\_\_\_

LEJA MJEDISORE \_\_\_\_\_

AKTIVITETI \_\_\_\_\_

**TE DHENAT E SUBJEKTIT  
QE GRUMBULLON DHE TRAJTON V.P.**

EMRI \_\_\_\_\_

NIPT

ADRESA \_\_\_\_\_

QYTETI \_\_\_\_\_

TELEFON \_\_\_\_\_

LEJA MJEDISORE \_\_\_\_\_

LICENCE \_\_\_\_\_

ADRESA (VENDI I GRUMBULLIMIT) \_\_\_\_\_

ADRESA (VENDI I TRAJTIMIT) \_\_\_\_\_

DATA E NGARKIMIT	ORA E NGARKIMIT	VENDI I NGARKIMIT	KODI I MBETJEVE	EMERTIMI I MBETJEVE	SASIA	MJETI I TRANSPORTIT	
					LITRA / TON	MARKA	TARGAT

DOREZUESI

EMER, MBIEMER, NENSHKRIM, VULE

\_\_\_\_\_

MARRESI

EMER, MBIEMER, NENSHKRIM, VULE

\_\_\_\_\_



# VETËM VAJ I PËRDORUR



**RREZIK TOKSIK**

**HELMUES  
PËR FRYMËMARRJE  
DHE GËLLTITJE**

**RUAJTJE  
NË AMBALLAZHIM TË VECANTË**

**MBETJE TË RREZIKSHME**

SIPAS LIGJIT Nr. 10463. Dt. 22. 09. 2011  
“PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË  
MBETJEVE DHE VKM Nr. 765 Dt. 07.11. 2012”  
PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR  
GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR DHE  
TRAJTIMIN E VAJRAVE TË PËRDORUR

**QENDRA PRODHUESE**

SUBJEKTI \_\_\_\_\_

ADRESA \_\_\_\_\_

TEL. \_\_\_\_\_

**DITA E FILLIMIT  
TË AMBALAZHIMIT  
DHE RUAJTJES**

\_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

**QENDRA E GRUMBULLIMIT:**

SUBJEKTI \_\_\_\_\_

ADRESA E GRUMBULLIMIT \_\_\_\_\_

TEL. \_\_\_\_\_

LOGO

**VENDIM**  
*(I shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1472, datë 23.9.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Erjon Korobacja, i biri i Ysniut dhe i Zares, i datëlindjes 1.4.1982, duke përcaktuar datë të vdekjes, datën 24.1.2010 dhe vendin e vdekjes, fshatin Mbrostar-Ura, rrethi Fier.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 22.10.2013  
Doli nga shtypi më 22.10.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 29 lekë